

REPUBLIKA E KOSOVËS  
JEVEKTA I KOSOVA  
MINISTRI E arsimit, shkencës dhe teknologjisë  
MINISTARSTVA ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGJIJU  
SEKTORIT ARNES-SEKTOR ARNWEARCHIVE-SEKTOR

|               |     |            |              |
|---------------|-----|------------|--------------|
| Njësia Org.   | 01B | Nr Prot.   | 1483         |
| Org. Jedinica |     | Broj Prot. |              |
| Org. Uini     |     | Prot. No.  |              |
| Nr i faqeve   |     | Data       |              |
| Br. stranica  | 2   | Datum      | 27 04 /20 15 |
| No. pages     |     | Date       |              |

Prishtinë, 27.04.2015



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje  
Nauku i Tehnologjiu - Ministry of Education, Science and Technology**

*Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister*

Nr. 176/01B  
Datë: 27 prill 2015

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (*Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010*), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), si dhe Ligjin nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative (*Gazeta zyrtare nr. 8, 1 janar 2007*), nenin 92, paragrafi (d), nxjerr:

**VENDIM**


1. Shfuqizohet vendimi nr. 2/1024, dt. 19.03.2015 për licencimin e Bartësit Privat të Arsimit të Lartë (BPrAL), Kolegji i Menaxhmentit Internacional "Globus" - dega në Podujevë, për nivelin Bachelor në kohëzgjatje për një vit akademik 2014/2015.
2. Pavlefshmëria absolute e vendimit 2/1024, të dt. 19.03.2015, e shpallur përmes këtij vendimi, ka efekt juridik në kuptim të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative.
3. Udhëzohet BPrAL, Kolegji i Menaxhmentit Internacional "Globus" - dega në Podujevë, në përmbushjen e detyrimeve ligjore në fuqi, që lindin si pasojë e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 2/1024, të dt. 19.03.2015, objekt procedural i të cilit ishte kërkesa e tij për licencim, nr. 4344, dt. 13 gusht 2014.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MASHT që të njoftoj BPrAL, Kolegji i Menaxhmentit Internacional "Globus" - dega në Podujevë për vendimin për shfuqizimin e vendimit nr. 2/1024, dt. 19.03.2015.

5. Obligohet Departamenti i Inspeksionit të Arsimit, MASHT që në pajtim me Ligjin Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë dhe Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, të inspektoj zbatimin e këtij vendimi dhe kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.

### Arsyetim

Vendimi nr. 2/1024, dt. 19.03.2015, përbën shkelje thelbësore të ligjit, me pasojë pavlefshmërinë absolute të tij, meqenëse është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar me ligj, respektivisht, në kundërshtim me kushtet dhe kriteret ligjore për licencim të përcaktuara në Ligjin nr. 04/L-037, për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nenin 14 (*Licencimi i bartësve të arsimit të lartë*) dhe Udhëzimin Administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, nenit 7 (*Kushtet dhe kriteret*). Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. dr. Arsim Bajrami, *ministër*



### Vendimi ju dërgohet:

1. BPrAL, Kolegji i Menaxhmentit Internacional "Globus";
2. Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
3. Kabinetit të Ministrit, MASHT;
4. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
5. Departamentit të Inspeksionit të Arsimit, MASHT;
3. Departamentit të Arsimit të Lartë MASHT;
6. Departamentit Ligjor, MASHT;
7. Arkivit, MASHT.